

UNMIK/RREG/2000/45
11 gusht 2000

RREGULLORE NR. 2000/45

MBI VETËQEVERISJEN E KOMUNAVE TË KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Regulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korik 1999, të ndryshuar, mbi autoritetin e Misionit të Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregullorën nr. 2000/1 të datës 14 dhjetor 2000 mbi Strukturën e Përbashkët Administrative të Kosovës,

Me qëllim të organizimit dhe mbikëqyrjes së zhvillimit të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisjen demokratike dhe autonome të Kosovës deri në vendimin politik të statusit përfundimtar të Kosovës,

Duke iu referuar Kartës Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale, e veçmas nenit 3 i cili përcakton të drejtat dhe kompetencat e organeve lokale, brenda kufijve të ligjit, për të rregulluar dhe udhëhequr një pjesë substanciale të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës vendore,

Duke marrë parasysh Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe protokolet e tyre, Kartën Evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave, strukturën e Konventës së Këshillit Evropian për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave,

Shpall sa vijon:

Kapitulli 1

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Institucionet e përkohshme

1.1 Deri në vendimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, me këtë Rregullore, në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, themelohen institucionet e përkohshme për vetëqeverisje autonome dhe demokratike në nivel komunal si hap drejt bartjes progresive të përgjegjësiwe administrative të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i cili do të mbikëqyrë dhe ndihmojë konsolidimin e këtyre institucioneve.

1.2 Sipas kësaj Rregulloreje "Pushtet Qendror" është UNMIK-u, i cili vepron sipas autoritetit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP).

Neni 2

Komunat në Kosovë

2.1 Njësia themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna, e cila ushtron tërë pushtetin, i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për Pushtetin Qendror.

2.2 Komunat rregullojnë dhe udhëheqin çështjet publike në territorin e tyre brenda kufijve të përcaktuar me ligj, për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës. Ato mund të kujdesën për çështje me interes të përgjithshëm që kanë të bëjnë me komunën dhe tyç cilat nuk i përkasin vetëm Pushtetit Qendror apo ndonjë organi tjetër.

2.3 Të gjitha organet dhe instancat e komunës kujdesën që banorët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendim tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta të barabarta dhe të drejta për punësim në shërbimet komunale të gjitha niveleve. Komunat në politikën dhe praktikën e tyre duhet të vëjnë në veprim nevojën për nxitjen e bashkëjetesës mes banorëve dhe të krijojnë kushte adekuate për t'u mundësuar të gjitha komuniteteve që ta shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor. Në këtë Rregullore, nocioni "bashkësitë kombëtare" nënkupton bashkësitë e banorëve që i përkasin grupit të njëjtë etnik, fetar ose gjuhësor.

2.4 Çdo komunë e ka statusin e vet juridik, të drejtën për të poseduar dhe administruar pronën, mundësinë për të ushtruar padi dhe për të qenë i paditur në gjykata, të drejtën për të lidhur kontrata dhe të drejtën për të marrë punëtorë në punë.

2.5 Ndryshimet e kufijve të komunave mund të bëhen vetëm nga Pushteti Qendror dhe vetëm pas konsultimeve paraprake me komunat përkatëse.

Neni 3
Përgjegjësitë dhe pushteti i komunave

3.1. Çdo komunë brenda territorit të vet dhe brenda ligjeve ekzistuese që rregullojnë secilin aktivitet është përgjegjëse për aktivitetet vijuese:

- (a) Ofrimin e kushteve themelore lokale për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- (b) Planifikimin urban dhe të fshatit dhe shfrytëzimin e tokës;
- (c) Lëshimin e lejeve për ndërtim dhe zhvillime të tjera;
- (ç) Mrojtjen lokale të ambientit;
- (d) Zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe kontrollimin e standardeve të ndërtimit;
- (dh) Ofrimin e shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës duke përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujrave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale, transportin lokal dhe planet për ngrohtoret lokale;
- (e) Shërbimet publike duke përfshirë shërbimin e zjarrfikësve dhe të emergjencës;
- (ë) Udhëheqjen e pronës së komunës;
- (f) Shkollimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- (g) Kujdesin primar shëndetësor;
- (h) Shërbimet sociale dhe strehimin;
- (i) Mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetin publik;
- (j) Lëshimin e lejeve për shërbime dhe pajisje, duke përfshirë argëtimin, ushqimin, tregjet, shitjet në rrugë, transportin lokal publik dhe shërbimin e taksistëve, gjuetinë e peshkimit, restorantet dhe hoteleve;
- (k) Panairet dhe tregjet;
- (l) Emërimin dhe riemërimin e rrugicave, rrugëve dhe vendeve të tjera publike në pajtim me dispozitat e kapitullit 1, neni 9 dhe kapitullit 2, neni 11;
- (ll) Sigurimin dhe mirëmbajtjen parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave.
- (m) Aktivitetet e tjera të ngjashme dhe të rëndësishme për administrimin adekuat të territorit komunal, që nuk janë të përcaktuar gjetiu me ligj.

3.2 Përveç aktiviteteve të caktuara me nenin 3.1, komunat mund të ndërmarrin veprime në territorin e tyre edhe rreth qështjeve të tjera komunale. Këtu mund të përfshihen aktivitetet vijuese:

- (a) Turizmi;
- (b) Aktivitetet kulturore;
- (c) Sportet dhe aktivitetet e lira;
- (ç) Aktivitetet e rinisë;
- (d) Avancimi ekonomisë;
- (dh) Avancimi i vlerave qytetare.

3.3 Komunat janë gjithashtu përgjegjëse edhe për zbatimin e rregulloreve të Pushtetit Qendror duke përfshirë të dhënat kadastrale, regjistrat e popullsisë, regjistrimin e votuesve dhe regjistrimin e bizneseve. Burimet përkatëse për këto qëllime i sigurohen komunës nga Pushteti Qendror.

3.4 Pushteti Qendror mund t'i lejojë kompetenca plotësuese komunës brenda suazave të autoritetit të Pushtetit Qendror, me kusht që t'i sigurohen komunës burimet financiare përkatëse.

3.5 Pushteti Qendror mund të ushtrojë mbikëqyrje administrative mbi komuna për të siguruar respektimin e ligjit dhe sistemit rregullues, duke përfshirë riejtjen e standardeve të pranuar.

3.6 Përveç për qështjet e saktësuara në kapitullin 2, neni 11.3, komunat në bashkëpunim me njëra tjetrën mund të lidhin marrëveshje për ushtrimin e cilësdo nga përgjegjësitë dhe kompetencat e veta.

Neni 4

Rregulloret lokale të komunës

4.1 Komunat mund të nxjerrin rregullore lokale të komunës që i përkasin çështjeve përbrenda kompetencave të komunës. Statuti i komunës duhet të mundësojë kushte për miratimin dhe publikimin e tyre pas konsultimit publik.

4.1.1 Asnjë rregullore lokale e komunës nuk mund të jetë e vlefshme nëse është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane

5.1 Çdo komunë, brenda territorit të vet, bën marrëveshje me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane përbrenda territorit të saj, në mënyrë që të sigurojë përmbushjen e nevojave të të gjithë banorëve në komunë.

5.2 Me pëlqimin e komunës, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, vetëm apo në grupe, mund të ushtrojnë aktivitete që janë në përgjegjësinë dhe kompetencën e komunës. Në këtë rast, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane marrin fonde gjegjëse nga komuna. Nëse

komuna nuk e miratimin kryerjen e aktiviteteve të tilla, atëherë fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane mund të kërkojnë përlqim nga Pushteti Qendror për t'i kryer ato aktiviteteve.

5.3 Statuti dhe Rregulloret lokale të komunës duhet të përcaktojnë formën e bashkëpunimit ndërmjet të komunës e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane lidhur me vëllimin e punës, organizimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Të gjitha fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane duhet t'i përmbahen ligjit në fuqi kur ndërmarrin aktivitete në marrëveshje me komunën.

Neni 6 Organizatat jofitimprurëse

6.1 Komuna mund ta përkrahë funksionimin e organizatave jofitimprurëse, duke përfshirë shoqatat e anëtarëve të komuniteteve, nëse organizatat e tilla ofrojnë shërbime në kuadër të përgjegjësisë së përgjithshme të komunës.

6.2 Komuna mund të bëjë marrëveshje me cilëndo organizatë të tillë me qëllim të ofrimit të shërbimeve. Të gjitha organizatat e tilla duhet t'i përmbahen ligjit në fuqi kur i ofrojnë shërbime komunës.

Neni 7 Mledhjet dhe dokumentacioni

7.1 Në pajtim me nenet 7.3 dhe 7.4, lejohet pjesëmarrja e publikut, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e shtypit, në të gjitha mbledhjet e kuvendeve komunale dhe komiteteve të tij.

7.2 Në pajtim me nenin 7.3, çdo person ka të drejtë t'i inspektojë dokumentet e komunës që janë në dispozicion.

7.3 Të drejtat e dhëna me nenet 7.1 dhe 7.2 mund të tërhiqen nëse zbatimi i tyre mund të shkaktojë çrregullim publik apo dhunë dhe nëse zbatimi i tyre do të rezultojë në zbulimin:

(a) e informatave të ofruara nga Pushteti Qendror për ndonjë çështje të natyrës konfidenciale;

(b) e informatave të ndjeshme personale ose komerciale;

(c) informatava që kanë të bëjnë me proceset aktuale apo të mundshme gjyqësore.

7.4 Kuvedni komunal dhe komitetet e tij vendosin për përjashtimin e publikut nga e tërë apo një pjesë e mbledhjes, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e mediave, çdoherë kur natyra e çështjes që diskutohet mund të marrë përmasa që mund të jenë të dëmshme për interesin e përgjithshëm publik.

7.5 Statuti mund të sigurojë kushte për pjesëmarrjen e publikut në mbledhje.

Neni 8
Tubimet publike dhe petitionet

8.1 Çdo komunë duhet të organizojë tubime periodike publike, së paku dy herë në vit, ku të cilat të gjithë njerëzit apo subjektet e interesuar në komunë mund të marrin pjesë. Data dhe vendi i tubimit publikohen së paku dy javë para takimit. Në tubim, përfaqësuesit e komunave i informojnë pjesëmarrësit për aktivitetin e komunës dhe pjesëmarrësit mund t'u shtrojnë pyetje dhe t'u japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal.

8.2 Çdo person apo organizatë që ka interes në komunë ka të drejtë t'i paraqesë petition kuvendit komunal për çfarëdo çështje që ka të bëjë me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Kuvendi komunal e shqyrton petitionin në pajtim me Statutin dhe rregullat procedurale të tij.

Neni 9
Gjuhët

9.1 Anëtarët e bashkësive kombëtare kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre me të gjitha organet e komunës dhe me të gjithë nëpunësit civilë të komunës.

9.2 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve të tij dhe tubimet publike, të gjitha duhet të mbahen në të dy gjuhët: shqip dhe serbisht. Në komunat ku gjuha e komuniteteve nuk është as shqipja as serbishtja, aktet dhe procesverbalet gjithashtu duhet të përkthehen në gjuhën e këtyre komuniteteve sa here që paraqitet nevoja.

9.3 Të gjitha dokumentet zyrtare të komunës shtypen në dy gjuhë: shqip dhe serbisht. Në komunat ku jetojnë bashkësitë kombëtare, gjuha e të cilave nuk është as shqipja e as serbishtja, të gjitha dokumentet zyrtare shtypen gjithashtu edhe në gjuhën e këtyre komuniteteve.

9.4 Shenjat zyrtare që tregojnë ose mbajnë emrat e qyteteve, qytezave, fshatrave, udhëve, rrugëve dhe vendeve të tjera publike duhet t'i japin ato në gjuhën shqipe dhe serbe. Në komunat ku jeton një komunitet, gjuha e të cilit nuk është as shqipja e as serbishtja, ata emra duhet të jepen edhe në gjuhën e këtij komuniteti.

9.5 Statuti i komunës duhet të përfshijë dispozita të detajuara për përdorimin e gjuhës së komuniteteve kombëtare, ashtu siç parashihet në këtë nen, duke pasur parasysh përbërjen e komuniteteve kombëtare në komunë.

Kapitulli 2
Kuvendi i komunës dhe komitetet e tij

Neni 10
Zgjedhja e kuvendit komunal

10.1 Organi më i lartë përfaqësues i komunës është kuvendi komunal, i cili zgjedhet në mënyrë direkte. Pushteti dhe detyrat e komunës ushtrohen nga kuvendi komunal dhe organet e tij, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga kjo rregullore.

10.2 Numri i komunave në Kosovë dhe numri i anëtarëve të kuvendit komunalë në komuna është si vijon:

Prishtinë/Priština	51
Podujevë/Podujevo	41
Prizren/Prizren	41
Suharekë/Suva Reka	41
Gjakovë/Đakovica	41
Pejë/Peć	41
Mitrovicë/Mitrovica	41
Gjilan/Gnjilane	41
Ferizaj/Uroševac	41
Malishevë/Mališevo	31
Gillogovc/Glogovac	31
Lipjan/Lipljan	31
Rahovec/Orahovac	31
Deçan/Dečani	31
Istog/Istok	31
Klinë/Klina	31
Skenderaj/Srbica	31
Vushtri/Vučitrn	31
Kaçanik/Kaçanik	31
Kamenicë/Kamenica	31
Viti/Vitina	31
Fushë Kosovë/Kosovo Polje	21
Obiliq/Obilić	21
Shtime/Štimlje	21
Dragash/Dragaš	21
Leposaviq/Leposavić	17
Zubin Potok/Zubin Potok	17
Zveçan/Zvečan	17
Novobërdë/Novo Brdo	17
Shtërpçë/Štrpce	17

10.3 Mandati i parë i anëtarëve të kuvendit komunal është dy vjet. Pastaj çdo mandat i anëtarëve të kuvendit të komunës është katërvjeçar.

10.4 Të gjithë anëtarët e kuvendit komunal kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta dhe mundësi për të marrë plotësisht pjesë në proceset e Kuvendit. Kuvendi komunal kujdeset që këto të drejta dhe mundësi të përfshihen në Statutin dhe rregullat procedurale të tij.

Neni 11

Funksionet e kuvendit komunal

11.1 Kuvendi komunal miraton Statutin dhe e ndryshon atë nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Statuti rregullon zbatimin e përgjegjësive të komunës ashtu si është përcaktuar me këtë Rregullore. Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Statutit miratohet me më shumë se dy të tretat e anëtarëve të pranishëm që votojnë në mbledhjen ku shqyrtohet propozimi.

11.2 Kuvendi i komunës i miraton rregullat e procedurës dhe mund t’i ndryshojë ato nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Rregullat e procedurës duhet të sigurojnë udhëheqjen dhe kontrollin, duke përfshirë kontrollin efikas financiar të administratës së komunës. Vendimi për miratimin apo ndryshimin e rregullave të procedurës aprovet nga më shumë se gjysma e anëtarëve prezentë që votojnë në mbledhjen ku shqyrtohet propozimi.

11.3 Kuvendi i komunës nuk mund ta bartë (delegojë) përgjegjësinë e vet për marrjen e vendimeve lidhur me:

- (a) miratimin e buxhetit;
- (b) miratimin e çështjeve të tjera financiare të cilat sipas Statutit dhe rregullave të procedurës i janë lënë kuvendit;
- (c) kompenzimet për anëtarët e zgjedhur;
- (ç) raportin vjetor;
- (d) miratimin, ndryshimin dhe anulimin e ligjeve lokale;
- (dh) krijimin i komiteteve që kërkohen me këtë Rregullore;
- (e) zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës;
- (ë) emërimin e Kryeshefit ekzekutiv;
- (f) emërimin e bordit të drejtorëve;
- (g) nivelin e pagesave dhe çmimeve;
- (h) krijimin dhe përdorimin i simboleve, dekorimeve dhe titujve të nderit, në përputhje me rregulloret e Pushtetit Qendror;
- (i) emërtimin dhe riemërtimin e rrugicave, rrugëve dhe vendeve të tjera publike;
- (j) bërjen e planeve dhe marrëveshjeve në pajtim me kapitullin 1, neni 3.6.

11.4 Kuvendi komunal mund t’ia delegojë pushtetin për të marrë vendime ngarkojë një komiteti të kuvendit komunal, kryetarit të komunës apo kryeshefit ekzekutiv. Kuvendi i komunës mund të revokojë delegimin në çdo kohë. Kompetenca e deleguar mund të bartet edhe më tej brenda autoritetit të dhënë me këtë rregullore.

11.5 Vendimi për emërtimin apo riemërtimin e çfarëdo rrugice, rruge apo vendi tjetër publik duhet të miratohet nga më së paku dy të tretat e anëtarëve të kuvendit komunal.

Neni 12

Mbledhja e parë dhe betimi apo deklarata anëtarëve

12.1 Kuvendi komunal e mban mbledhjen e parë inauguruese brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e verifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Përfaqësuesi më i vjetër i kuvendit e kryeson çdo mbledhje deri sa kryetari ta ketë dhënë betimin apo deklaratën solemne.

12.2 Anëtarët e kuvendit të komunës duhet ta nënshkruajnë betimin apo deklaratën solemne. Forma e betimit apo deklaratës solemne është si vijon :

“Betohe (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, me besnikëri, pa anim ee me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtrojë autorizimet e mia si anëtar i kuvendit të komunës së _____, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.”

Neni 13

Kryesimi i mbledhjeve

13.1 Kuvendi komunal e zgjedhë kryetarin e komunës, i cili i thirrë mbledhjet dhe i kryeson mbledhjet e kuvendit komunal. Rregullat e procedurës rregullojnë mënyrën e thirrjeve dhe udhëhiqen e kuvendit.

13.2 Rregullat e procedurës rregullojnë gjithashtu qështjen e thirrjes dhe udhëheqjes së mbledhjeve nëse vendet e kryetarit dhe zëvendëskryetarit janë të lira, apo nëse të dy, për çfarëdo arsye, nuk janë në gjendje të marrin pjesë në mbledhje.

Neni 14

Kuorumi dhe mbledhjet

14.1 Kuorumi për të gjitha mbledhjet e kuvendit komunal dhe komitetet e tij përbëhet nga gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje me të drejtë pjesëmarrje dhe votimi.

14.2 Në të gjitha mbledhjet e kuvendit të komunës dhe të komiteteve, të gjithë anëtarët, duke përfshirë edhe kryesuesin e mbledhjes, kanë vetëm një votë, por kryesuesi e ka një votë shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave për ose kundër ndonjë propozimi.

14.3 Kuvendii Komunal dhe komitetet marrin vendime me votim të hapur, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Rregullore.

14.4 Vendimet e kuvendit të komunës dhe të komiteteve të tij merren thjeshtë me votimin e shumicës së anëtarëve prezentë, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Rregullore.

Neni 15

Mbledhjet

15.1 Kuvendi i komunës mblidhet sa herë që kjo parashihet me rregullat e procedurës, por duhet të mbajë së paku dhjetë mbledhje të komunës brenda vitit fiskal.

15.2 Mbledhjet e kuvendit të komunës gjithashtu mund të thirren nga çereku i numrit të të gjithë anëtarëve të zgjedhur ose nga komiteti i kuvendit.

15.3 Së paku shtatë ditë pune para çfarëdo mbledhjeje të kuvendit të komunës, ose ekskluzivisht, tri ditë pune më herët në raste urgjente, anëtarët e Kuvendit duhet të njoftohen me kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes si dhe me rendin e ditës së asaj mbledhjeje. Njoftimet publike për këto duhet po ashtu të shpallen në të njejtën kohë.

Neni 16 Procesverbali

16.1 Për të gjitha mbledhjet e kuvendit të komunës dhe të komiteteve të tij duhet të mbahet procesverbali. Procesverbali duhet të përmbajë emrat e anëtarëve prezentë dhe anëtarëve të ftuar, rendin e ditës, thelbin e diskutimit, rezultatin numerik të votimit, çfarë vote ka dhënë çdonjëri dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara. Nëse kërkohet të thirret emri i çdo anëtarë, në procesverbal duhet shënuar si ka votuar secili.

16.2 Procesverbalin duhet ta mbajë kryeshefi ekzekutiv dhe ai duhet të miratohet në mbledhjen e ardhshme. Çdokush ka të drejtë ta shikojë procesverbalin dhe ta marrë një kopje.

16.3 Kryesuesi dhe kryeshefi ekzekutiv, apo zëvendësit e tyre, duhet ta nënshkruajnë procesverbalin.

Neni 17 Konflikti i interesave

17.1 Anëtarë i kuvendit të komunës apo i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.

17.2 Çdo anëtar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesave që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent. Çdo anëtar mund të ofrojë informacione që janë në interes të anëtarit tjetër.

17.3 Çdo anëtarë mundet vullnetarisht të tërhiqet nga procesi i marrjes së vendimeve dhe procedurat administrative, nëse konsideron se ato mund të çojnë deri te konflikti i interesave.

17.4 Anëtarët e kuvendit të komunës nuk mund të punësohen nga komuna në asnjë pozitë udhëheqëse.

17.5 Para mbledhjes së parë të kuvendit të komunës, anëtarët e kuvendit duhet t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare dhe këtë regjistër e mban drejtori ekzekutiv. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.

17.6 Kur ekzistojnë konflikte të interesave, Statuti dhe rregullat e procedurës duhet të pëcaktjnë masat për përjashtimin e anëtarëve nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative.

Neni 18 Autorizimet plotësuese të anëtarëve të kuvendit të komunës

Anëtarë i kuvendit të komunës ka të drejtë:

(b) Të kërkojë informacione nga kryetari, zëvendëskryetari, drejtori ekzekutiv apo kryesuesi i komitetit. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe në rregullat procedurale.

(b) Të dorëzojë vërejtje me shkrim të cilat do t'i bashkëngjiten procesverbalit.

(c) Të diskutojë, por nuk mund të votojë në mbledhjet e komitetit të kuvendit në të cilat ai ose ajo nuk është anëtar. Ai ose ajo mund t'i propozojë kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është në përgjegjësi të komitetit.

(ç) Të kërkojë nga drejtorët të dhëna dhe ndihmë të nevojshme administrative të arsyshme për punën e tij apo të saj si drejtor. Nëse ai apo ajo nuk është i pakënaqur me përgjigje, ai po ajo mund të ngrisin çështjen në Kuvendin Komunal.

(d) Të kërkojë informata dhe ndihmë të arsyeshme administrative nga bordi i drejtorëve, e cila është e nevojshme për punën e tij ose të saj si anëtar. Nëse ai ose ajo nuk është i kënaqur me përgjigje, ai ose ajo mund ta ngrisë çështjen në kuvendin komunal.

Article 19 Punësimi dhe kompensimi

19.1 Punëdhënësit duhet t'u lejojnë anëtarëve të kuvendit që të mungojnë nga vendet e tyre të punës për periudhën e arsyshme kohore e cila nevojitet për punën e kuvendit.

19.2 Kuvendi komunal mund t'i shpërblejë anëtarët e kuvendit, duke përfshirë edhe ata anëtarë që mbajnë postin e kryetarit ose zëvendëskryetarit për punën e tyre në komunë me anë të kompensimit të shpenzimeve, humbjeve financiare ose një shumë paushalle në pajtim me statutin dhe udhëzimet lëshuara nga Pushteti Qendror.

Neni 20 Shkarkimi

20.1 Anëtar i kuvendit të komunës i cili nuk e nënshkruan betimin ose deklaratën e detyrës brenda një muaji pas zgjedhjes pushon të jetë anëtar.

20.2 Anëtar i kuvendit i cili ka qenë i dënuar për kundërvajtje penale të dënueshme me tre muaj burgim dhe është lëshuar urdhri për burgim, pushon të jetë anëtar.

20.3 Nëse anëtar i kuvendit komunal nuk merr pjesë gjashtë muaj rresht në mbledhje të kuvendit komunal ose në komitetet e tij, ai ose ajo do të pushojë të jetë anëtar, përveç nëse ka munguar me arsye të miratuar nga kuvendit komunal.

20.4 Nëse një anëtar i kuvendit komunal e humb të drejtën për t'u zgjedhur në kuvendin komunal, ai apo ajo pushon së qeni anëtar.

Neni 21 Komitetet

21.1 Kuvendi komunal e cakton një Komitet për Politikë dhe Financa, një komitet për komunitetet dhe një komitet për ndërmjetësim, siç kërkohet me këtë rregullore.

21.2 Kuvendi komunal mund të caktojë edhe komitete të tjera dhe të vendosë për kompetencat dhe veprimtaritë e tyre.

21.3 Kuvendi komunal duhet të bëjë përpjekje që të sigurojë barazpeshë gjinore në të gjitha komitetet.

21.4 Komitetet e emëruara sipas nenit 21.2 mund të kooptojnë në radheët e tyre individë që nuk janë anëtarë të kuvendit komunal, por shumica e anëtarëve të komiteteve duhet të jenë gjithëmonë anëtarë të kuvendit komunal.

21.5 Anëtarësimi në çdo komitet duhet të pasqyrojë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e vendeve që i mbajnë partitë politike dhe koalicionet në kuvendin komunal, përveç rasteve kur kërkohet ndryshe me këtë rregullore.

21.6 Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i çdo komiteti zgjidhet nga anëtarët dhe prej anëtarëve të komitetit, përveç në rastet kur kërkohet ndryshe me anë të kësaj rregulloreje.

21.7 Çdo komitet vendosë për kohën e mbajtjes së mbledhjeve në pajtim me rregullat e procedurës.

21.8 Mbledhja e komitetit konvokohet nëse kryesuesi i komitetit mendon se kjo është e nevojshme ose me kërkesën me shkrim të së paku një të tretës së anëtarëve të tij.

Neni 22

Komiteti për politikë dhe financa

22.1 Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për propozimin e buxhetit, për formulimin dhe hulumtimin e drejtimit strategjik të komunës në të ardhmen.

23.2 Kryetari i komunës është kryesues i komitetit.

24.3 Kryesuesit e Komiteteve të tjera janë të autorizuar të marrin pjesë në mbledhjet e komitetit për politikë dhe financa.

Neni 23

Komiteti i komuniteteve, komiteti për ndërmjetësim dhe zyra e komunitetit

23.1 Kuvendi komunal themelon dhe mban Komitetin e komuniteteve dhe një Komitet ndërmjetësues, si komitet të përhershëm.

23.2 Të drejtat e komitetit të komuniteteve të parapara në këtë nen janë shtesë e të drejtave të anëtarit të Komitetit apo të komunitetit ose të qytetarit, i cili mund ta paraqesë çështjen te ombudspersoni apo në gjykatë.

23.3 Procedurat për emërimin e anëtarëve të komitetit të komuniteteve dhe të komitetit për ndërmjetësim rregullohen me anë të statutit. Procedurat duhet të garantojnë që:

(a) anëtarësia e komitetit të komuniteteve të përfshijë anëtarë të kuvendit dhe përfaqësues të komuniteteve,

(b) çdo komunitet që jeton në komunë të përfaqësohet së paku me nga një anëtar të komitetit të komunitetit;

(c) komuniteti i cili është shumicë në komunë të ketë më pak se gjysmën e e numrit të anëtarëve të komitetit të komuniteteve dhe që pjesa tjetër e anëtarëve të komitetit të komuniteteve në komunë të pasqyrojë përafërsisht numrin e komuniteteve tjera në komunë dhe

(ç) Komiteti për ndërmjetësim të ketë numër të barabartë:

(i) të anëtarëve të Kuvendit Komunal, të cilët nuk janë anëtarë të komitetit të komuniteteve dhe

(ii) të përfaqësuesve në përpjesëtim të drejtë të komuniteteve të komunës, të cilët nuk i takojnë komunitetit që është shumicë në komunë.

23. 4. Komiteti i komuniteteve bën përpjekje në kuadër të territorit të komunës të sigurojë që:

(a) asnjë person i cili merr përsipër detyra publike ose mban post publik nuk guxon të bëjë diskriminim ndaj asnjë personi, në kurrfarë baze, për shkak të gjuhës, përkatësisë etnike, ose shoqërimit me komunitetin;

(b) të gjithë personat të gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe mundësi të drejtë e të barabartë punësimi në shërbimet komunale në të gjitha nivelet;

(c) që shërbimi komunal civil të pasqyrojë në proporcion të drejtë numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet.

23.5 Komiteti i komuniteteve i përkrah të drejtat dhe intereset e komuniteteve që jetojnë në atë komunë dhe veç kësaj përkrah një shoqëri, ku traditat e ndryshme kulturore, shoqërore dhe fetare jo vetëm do të tolerohen por edhe do të inkurajohen.

23.6 Nëse Komiteti i komuniteteve mendon se janë ndërmarrë masa, ose janë propozuar që të ndërmerren, nga ose në emër të Kuvendit Komunal, i cili ka shkelur ose mund t'i shkelë të drejtat e një komuniteti a të një anëtari të komunitetit, ose të cilat mund jenë të dëmshme për interesat e komunitetit, duhet t'ia paraqesë menjëherë çështjen komitetit për ndërmjetësim.

23.7 Komiteti për ndërmjetësim i shqyrton të gjitha çështjet të cilat Komiteti i komuniteteve ia parashtron. Ky komitet kryen aso hetime të nevojshme për të konstatuar se a janë shkelur apo mund të shkilen të drejtat e një komuniteti, apo nëse është ndërmarrë apo propozuar ndonjë masë ndaj atij veprimi që është apo mund të jetë i dëmshëm për interesat e komunitetit. Komiteti duhet të përpiket që rastin ta zgjidhë me anë të ndërmjetësimit. Komiteti për ndërmjetësim i paraqet raport kuvendit komunal brenda afatit prej 28 ditësh për çdo çështje, duke dhënë rekomandime lidhur me shqyrtimin e asaj çështjeje.

23.8 Kuvendi komunal shqyrton çdo raport që i dorëzohet nga Komiteti për ndërmjetësim dhe vendosë se çfarë veprimi duhet të ndërmerret tani apo në të ardhmen lidhur me atë rast. Vendimi i komitetit duhet të jetë në pajtim me ligjin dhe me parimet e parapara në këtë

Rregullore, e veçmas me ato të parapara në kapitullin 1, neni 2.3, në nenin e tanishëm 23 dhe në kapitullin 5, neni 34.

23.9 Nëse kuvendi komunal nuk arrin të bie vendim sipas nenit 23.8 brenda afatit prej 21 ditësh pas dorëzimit të raportit të komitetit për ndërmjetsim, ose nëse komiteti i komuniteteve është i pakënaqur me vendimin e kuvendit komunal sipas nenit 2.3, vendimi mund t'i dorëzohet Pushteti Qendror për shqyrtim.

23.10 Gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të pushtetit të tyre sipas kapitullit 1, neni 5, komunat duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë përmbushjes së nevojave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të cilat janë të banuara me komunitete, që nuk janë shumicë në atë komunë.

23.11 Zyra e komunitetit themelohet në ato komuna ku komuniteti i cili nuk është shumicë përbën një pjesë të rëndësishme të asaj populate. Zyrat e komuniteteve janë të përkohshme dhe do të ekzistojnë për aq sa Pushteti Qendror e konsideron të nevojshme dhe në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

23.12 Zyra e Komunitetit është përgjegjëse për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të komunitetit dhe sigurimin e shërbimeve të barabarta publike në nivel komunal.

23.13 Zyra e komunitetit është pjesë integrale e komunës dhe e struktures së përbashkët administrative. Atë e themelon komuna. Nënzyrat do të themelohen nëse ato nevojiten për të ofruar shërbime publike të sigurta dhe të lira.

23.14 Shefi i zyrës së komunitetit është sipas funksionit anëtar ex-officio i bordit të drejtorëve të komunës. Ai apo ajo i dërgojnë raport shkresë për secilën mbledhje të Komitetit të komunitetit, duke përshkruar në detaje punët e kryera për të cilat është përgjegjës ajo zyre e komunitetit.

23.15 Pushteti Qendror e shqyrton rregullisht nevojën e ekzistimit të çdo zyreje apo nënzyreje të komunitetit.

Kapitulli 3 **Kryetari dhe nënkryetarët e komunës**

Neni 24 Zgjedhja e kryetarit të komunës

24.1 Kuvendi komunal e zgjedhë kryetarin e komunës nga anëtarët e tij.

24.2 Kryetari i komunës zgjidhet për mandat të njëjtë sikurse anëtarët e kuvendit. Asnjë person nuk do të shërbejë më tepër se dy mandate si kryetar i komunës.

24.3 Votimi në të gjitha zgjedhjet për kryetar bëhet me vota të fshehta.

24.4 Për t'u zgjedhur në rrethin e parë, kandidati duhet të fitojë më tepër se dy të tretat e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të zgjedhur.

24.5 Nëse asnjë kandidat nuk fiton më tepër se dy të tretat e shumicës në rrethin e parë atëherë mbahet rrethi i dytë i zgjedhjeve.

24.6 Nëse asnjë kandidat nuk fiton më tepër se dy të tretat e shumicës në rrethin e dytë, dy kandidatët të cilët kanë fituar shumicën e votave në rrethin e dytë, shkojnë në rrethin e tretë.

24.7 Kandidati i cili fiton shumicën e votave në rrethin e tretë zgjedhet për kryetar.

Neni 25

Zëvendëskryetarët

25.1 Kuvendi komunal e zgjedhë zëvendëskryetarin nga anëtarët e tij për të ndihmuar kryetarin në punën e tij. Procedura e zgjedhjes është e njëjtë si ajo e përshkruar në nenin 24 për zgjedhjen e kryeatrit.

25.2 Zëvendëskryetari i kryen detyrat e tij ose të saj në pajtim me Statutin dhe rregullat e procedurës. Ai apo ajo i përgjegjësit kryetarit, përveç në rastet kur ai ose ajo e kryen detyrën në mungesë të kryetarit, në atë rast ai apo ajo i përgjigjet kuvendit komunal.

25.3 Në komunat ku jetojnë një apo më shumë komunitete, të cilët nuk janë shumicë dhe të cilët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të popullatës, emërohet një zëvendëskryetar plotësues nga ana e kuvendit komunal nga këto komuniteteve.

25.4 Kur mungon kryetari, zëvendëskryetari i emëruar sipas nenit 25.1 i merr përsipër të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat e kryetarit.

Neni 26

Dhënia e betimit ose e deklaratës

Me rastin e zgjedhjes, kryetari dhe zëvendëskryetari e japin betimin apo deklaratën solemne përpara anëtarëve të kuvendit komunal. Forma e betimit ose deklaratës është si vijon:

“Betohe (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia si kryetari/zëvendëskryetar i komunës së _____ me nder, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë.”

Neni 27

Shkarkimi nga detyra dhe vendi i punës

27.1 Kryetari dhe zëvendëskryetari mund të shkarkohen nga detyra vetëm me votat e më tepër se dy të tretave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur të kuvendit komunal dhe vetëm në rast se nuk janë përmbushur si duhet kërkesat e kësaj Rregulloreje. Votimi bëhet me vota të fshehta.

27.2. Nëse lirohet vendi i kryetarit ose zëvendëskryetarit, kuvendi komunal e zgjedhë kryetarin ose zëvendëskryetarin e ri jo më larg se tridhjetë ditë pas shpalljes së vendit të lirë. Procedura e zgjedhjes të përshkruar në nenet 24 dhe 25 zbatohen çdo herë kur të shpallet vend i lirë.

Neni 28
Përgjegjësitë

28.1 Kryetari i komunës bën mbikëqyrjen e përgjithshme të administrimit financiar të komunës dhe ekzekutimin e vendimeve të marra në kuvendin komunal.

28.2 Në varësi të kufizimeve të kompetencave të delegimit që i përmban kjo rregullore, kryetari ka kompetenca tjera të tilla që i caktohen atij ose asaj me anë të statutit dhe rregullave të procedurës.

28.3 Kryetari i komunës i kryen detyrat e tij ose të saj me ndihmën e zëvendëskryetarit, kryeshefit ekzekutiv dhe bordit të drejtorëve.

Neni 29
Kryetari dhe nënkryetari – konflikti i interesave

Përveç dispozitave të kapitullit 2, neni 17, kryetari dhe nënkryetarët pas zgjedhjes së tyre duhet të përfundojnë sa më shpejtë që është e mundur çdo kontratë ose lidhje që kanë, që mund ta vë në dyshim mundësinë e kryerjes së obligimeve të tyre në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Kapitulli 4
Kryeshefi ekzekutiv dhe bordi i drejtorëve

Neni 30
Kryeshefi ekzekutiv

30.1 Kuvendi i komunal, në bazë të propozimit të kryetarit, emëron një kryeshefi ekzekutiv, i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me statut.

30.2. Kryeshefi ekzekutiv, duke vepruar në bazë të kompetencave të plota të kuvendit komunal:

- (a) kryen detyrën e sekretarit të kuvendit komunal;
- (b) është kryesues i bordit të drejtorëve;
- (c) është përgjegjës për udhëheqjen efikase të çështjeve financiare të komunës, për mbajtjen dhe zbatimin e procedurave dhe kontrollimeve efektive financiare, në përputhje me kërkesat e Pushtetit Qendror;
- (ç) kryen të gjitha detyrat që i janë caktuar atij ose asaj me Statut dhe me rregullat e procedurës dhe

(d) kryen të gjitha detyrat tjera që i janë caktuar atij ose asaj nga kryetari ose nga Kuvendi komunal.

30.3 Kryeshefi ekzekutiv ose i emëruari i tij marrin pjesë dhe mund t'i drejtohen të gjitha sesioneve të kuvendit komunal dhe sesioneve të komiteteve.

30.4 Kryeshefi ekzekutiv njofton kuvendin komunal dhe kryetarin sa më shpejtë që të jetë e mundur për çdo veprim i cili merret ose propozohet, i cili mund të jetë në kundërshtim me ligjin apo me procedurat e buxhetit, rregulloret financiare ose rregullat e furnizimit ose që nuk është në përputhje me statutin dhe rregulloren e punës.

30.5 Kryeshefi ekzekutiv është drejtor i personelit. Emërimi, kushtet e shërbimit si dhe shkarkimi i të gjithë punonjësve të komunës, përveç anëtarëve të Bordit të drejtorëve, janë nën udhëheqjen e tij ose të saj.

30.6 Kuvendi komunal zgjidh çdo konflikt ndërmjet kryetarit dhe kryeshefitekzekutiv.

30.7 Nëse posti i kryeshefi ekzekutiv lirohet, kuvendi komunal në afat prej tre muajsh emëron një kryeshef të ri ekzekutiv i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me Statut.

30.8 Kryeshefi ekzekutiv mund të shkarkohet vetëm nga kuvendi komunal dhe atë vetëm për arsye të moskryerjes si duhet të obligimeve të tij ose të saj dhe në interes të efikasitetit.

Neni 31 Bordi i drejtorëve

31.1 Kuvendi komunal emëron një bord të drejtorëve, i cili përfshinë drejtorët e drejtorive komunale si dhe drejtorin e zyrës së komunitetit. Statuti përcakton numrin e drejtorëve, detyrat dhe obligimet e secilit drejtor, kushtet e nevojshme për emërim si dhe procedurat e emërimit.

31.2 Bordi i drejtorëve:

(a) ndihmon kuvendin komunal dhe komitetet e tij në sigurimin e të gjitha informatave dhe raporteve për procesin e marrjes së vendimeve;

(b) ndihmon kryetarin dhe kryeshefin ekezekutiv ekzekutiv;

(c) zbaton të gjitha vendimet e komunës.

31.3 Nëse lirohet ndonjë post në Bordin e drejtorëve, Kuvendikomunal e plotëson atë brenda tre muaj ditësh duke emëruar një Drejtor tjetër, i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me Statut.

31.4 Drejtorin mund ta shkarkojë vetëm kuvendi komunal dhe vetëm për arsye të moskryerjes si duhet të obligimeve të tij ose të saj ose kur nuk ka nevojë më për atë post.

Neni 32

Konfliktet e interesit - kryeshefi ekzekutiv dhe bordi i drejtorëve

32.1 Kryeshefi ekzekutiv përjashtohet nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjeje për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij a të saj, ka ndonjë interes personal ose financiar.

32.2 Drejtori përjashtohet nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjesh për të cilën ai ose ajo apo anëtari i ngushtë i familjes së tij a të saj, ka ndonjë interes personal ose financiar.

32.3 Nga kryeshefi ekzekutiv si dhe nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash në një regjistër të cilin e mban kryetari.

32.4 Statuti dhe rregullorja e punës përmban masat të cilat merren për të përjashtuar kryeshefin ekezekutiv ekzekutiv si dhe drejtorët nga vendimmarrja dhe procedurat administrative ku ata kanë ndeshje interesash.

Kapitulli 5

Ekzekutimi i çështjeve komunale

Neni 33

Parimet e ligjshmërisë

Ligji dhe drejtësia e obligojnë administratën e komunës që të zbatojë, në veçanti të drejtat dhe liritë e njeriut sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Të gjitha veprimet administrative duhet t'i përmbahen ligjit në fuqi.

Neni 34

Shërbimi civil komunal

34.1 Kryeshefi ekzekutiv, bordi i drejtorëve dhe personeli administrativ përbëjnë shërbimin civil administrativ.

34.2 Kushtet e shërbimit civil komunal duhet të jenë të tilla që të mundësojnë punësimin e personelit të nivelit të lartë në bazë të meritës dhe aftësisë.

34.3 Të gjithë nëpunësit civilë komunalë i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme dhe të drejtë duke rrespektuar dhe duke vepruar në pajtim me ligjin.

34.4 Të gjithë nëpunësit civilë komunalë i zbatojnë urdhrat e eprorëve të tyre dhe i përfillin urdhrat e tyre përveç nëse detyrat e dhëna janë në kundërshtim me ligjin, ose me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe me të drejtat e komuniteteve.

34.5 Shërbimi komunal në të gjitha nivelet duhet të pasqyrojë në mënyrë proporcionale numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve.

34.6 Nga të gjithë nëpunësit civilë komunal kërkohet t'i paraqesin me shkrim të gjitha konfliktet e interesave në një regjistër të cilin e ruan kryeshefi ekzekutiv.

34.7 Kryeshefi ekzekutiv, anëtari i bordit të drejtorëve ose drejtori, apo shef i departamentit, i zyrës ose i seksionit nuk mund të jetë anëtar i kuvendit komunal në komunën ku punojnë.

Kapitulli 6 **Ankesat dhe mbrojtja juridike**

Neni 35 Ankesat

35.1 Çdo qytetar mund të parashtojë ankesë ndaj vendimit administrativ të komunës, nëse ai apo ajo mendon se me kryeshefit atë vendim i janë cenuar të drejtat e tij ose të saj. Ankesat i dorëzohen me shkrim kryeshefit ekzekutiv, ose personalisht zyrës së kryeshefit ekzekutiv, brenda afatit prej një muaji pasi paraqitësi i ankesës të ketë mësuar për vendimin.

35.2 Kryeshefi ekzekutiv duhet ta rishqyrtojë ligjshmërinë e vendimit si dhe procesin administrativ me të cilin është arritur ai vendim. Ai ose ajo duhet të ofrojë një përgjigje të arsyeshme me shkrim brenda një muaji ditësh nga data e pranimi të ankesës.

35.3 Nëse nuk është i kënaqur me përgjegjen e kryeshefit ekzekutiv, parashtruesi i ankesës mund t'i drejtohet Pushtetit Qendror, i cili e shqyrton ankesën dhe vendos për ligjshmërinë e atij vendimi.

35.4 Pushteti Qendror duhet të marrë vendim brenda një muaji ditësh nga koha e pranimi të ankesës në lidhje me vendimin. Vendimi duhet të arsyetohet me shkrim dhe t'i komunikohet parashtruesit të ankesës dhe kryeshefit ekzekutiv.

35.5 Nëse ankesa ka të bëjë me vendimin e marrë nga kryeshefi ekzekutiv apo kundër tij, ankesa i dorëzohet kryetarit dhe do të zbatohen nenet 1.2, 1.3 e 1.4, duke zëvendësuar fjalën "kryetar" me fjalën " kryeshef ekzekutiv ".

35.6 Asnjë vendim administrativ nuk mund të ndërrohet në dëm të parashtruesit të ankesës, si pasojë e ankesës.

35.7 Të drejtat e përcaktuara me këtë nen janë të drejta shtesë të çfarëdo të drejtave të cilat personi mund t'i ketë për t'ia paraqitur një vendim administrativ ombudspersonit apo ndonjë gjykate.

Neni 36 Mbrojtja gjyqësore e ligjit

Qytetari mund të kërkojë zgjidhje për vendimet e ndonjë komune, në pajtim me rregullat dhe procedurat e gjykatës përkatëse.

Kapitulli 7 **Administrimi financiar**

Neni 37 Parimet e përgjithshme

37.1 Buxheti i komunës duhet të jetë i balancuar, i përgatitur në mënyrë transparente dhe i bazuar në kritere objektive.

37.2 Buxheti duhet të përmbajë planin për aktivitete dhe udhëheqje ekonomike brenda vitit fiskal dhe duhet të përfshijë të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimet kapitale dhe të përditshme të komunës. Ai gjithashtu duhet t'i ndajë fondet ekzistuese për nevojat e shpenzimeve të komunës.

37.3 Statuti dhe rregullat e procedurës i përcaktojnë procedurat buxhetore, standardet financiare dhe rregullat e furnizimit që i plotësojnë kriteret e parapara nga Pushteti Qendror.

Neni 38 Financimi nga Pushteti Qendror

38.1 Transferimet financiare për komuna i bën Pushteti Qendror duke u bazuar në kritere objektive, duke përfshirë edhe vlerësimin e nevojave dhe burimeve financiare për çdo komunë dhe prioritetet e shpenzimeve të përcaktuara nga Pushteti Qendror.

38.2 Një pjesë e fondeve të transferuara mund të ndahet për veprimtari specifike të përcaktuara në kapitullin 1, neni 3. Një pjesë e fondeve të transferuara nuk ndahet fare.

38.3 Komuna duhet të njihet me sasinë e fondeve të transferuara për vitin e ri fiskal në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Pushteti Qendror,.

Neni 39 Të hyrat komunale

39.1 Komuna mund të mbledhë të hyra në përputhje me ligjet dhe udhëzimet e Pushtetit Qendror për rregullimin përkatës të këtyre çështjeve nga:

- (a) licencat dhe pagesat që i cakton dhe i vë komuna;
- (b) të ardhurat dhe pasuria e komunës dhe
- (c) gjobat apo përqindja e gjobave.

Neni 40 Shërbimet publike të ndërmarrjeve komunale

40.1 Kur shërbimet publike kryhen nga ndërmarrjet komunale këto ndërmarrje duhet t'i dorëzojnë Kuvendit të Komunës buxhetin e tyre për miratim. Buxheti i propozuar duhet të përfshijë strukturën e tarifës së propozuar për kryerjen e shërbimeve dhe duhet të dorëzohet deri më 1 dhjetor para vitit të ardhshëm fiskal.

40.2 Kur një ndërmarrje kryen shërbimet publike lokale për më shumë se një komunë, atëherë ato komuna duhet të merren vesh për mbikëqyrjen e përbashkët të veprimtarisë së asaj ndërmarrjeje.

Neni 41 Miratimi i buxhetit

41.1 Viti fiskal i komunës fillon më 1 janar. Komiteti për politikë dhe financa i dorëzon kuvendit komunal buxhetin për miratim sa më të shpejtë që praktikisht është e mundur, pas njoftimit për lartësinë e fondit të ndarë për vitin vijues.

41.2 Në rastet kur një ndërmarrje ofron shërbime publike lokale për më shumë se një komunë, marrëveshjet bëhen me komunat gjegjëse për mbikëqyrje të përbashkët të veprimtaive të asaj ndërmarrjeje.

Neni 42 Raporti vjetor

42.1 Komuna e publikon raportin vjetor pas përfundimit të çdo viti fiskal. Raporti i prezantohet kuvendit komunal për aprovim jo më vonë se më 30 maj të vitit vijues. Raporti duhet të përmbledhë pikësynimet e komunës në lidhje me veprimtaritë e saj për të cilat është përgjegjëse dhe duhet të vlerësojë nivelin e arritjes së pikësynimeve për atë vit fiskal. Raporti duhet të sqarojë mënyrën e financimit veç e veç të atyre aktiviteteve dhe duhet të tregojë gjendjen financiare të komunës në fund të atij viti fiskal. Ai duhet të përmbajë edhe deklaratat mbi kontrollin financiar. Këto kërkesa duhet të përfshijnë edhe veprimtaritë e ndërmarrjeve komunale, përkrahjen e dhënë organizatave jofitimprurëse si dhe punët tjera në lidhje me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Neni 43 Kontrolli i pavarur financiar

43.1 Pushteti Qendror cakton revizorë të pavarur financiarë me qëllim të kontrollimit të deklaratave financiare të çdo komune.

43.2 Revizori ka të drejtë t'i shikojë të gjitha deklaratat financiare, librat, shkresat dhe dokumentet tjera dhe mund t'i kërkojë të gjitha të dhënat, të cilat atij apo asaj i duhen për kryerjen e kontrollit.

43.3 Revizori i kontrollon të gjitha deklaratat financiare të ndërmarrjeve komunale.

43.4 Revizori i inspekton të gjitha deklaratat financiare të të gjitha organizatave jofitimprurëse të cilat marrin ndihmë financiare nga komunat.

43.5 Çdokush mund t'i paraqesë ankesë revizorit lidhur me deklaratat financiare dhe eështjet tjera financiare të komunës dhe revizori mund të bëjë hetime lidhur me ato.

43.6 Revizori i dorëzon kuvendit komunal raport me shkrim për çdo revizion financiar, për të cilin kuvendi komunal merr vendim për veprimet që duhet të ndërmerren lidhur me secilin rekomandim që përmban raportin. Kuvendi nuk mund ta refuzojë pa arsye të maftueshme asnjërin prej rekomandimeve dhe arsyet duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes përkatëse.

43.7 Çdo raport i revizorit duhet të bëhet publik.

Kapitulli 8 **Pasuria e Komunës**

Neni 44 Toka dhe objektet

44.1 Kryeshefi ekzekutiv kujdeset për përgatitjen dhe mbajtjen e shënimeve për tërë tokën dhe objektet të cilat i posedon apo i shfrytëzon komuna.

44.2 Komuna nuk mund të shesë apo të japë me qira tokë ose objekte komunale për më shumë se dhjetë vjet pa miratimin e Pushtetit Qendror.

Neni 45 Pasuritë e tundshme

45.1 Kryeshefi ekzekutiv duhet të kujeset për përgatitjen dhe mbajtjen e një inventarit të mjaftueshëm për tërë pasurinë e tundshme që posedon komuna.

Kapitulli 9 **Dispozitat veçanta**

Neni 46 Bartja e pushtetit komunave

46.1 Deri sa të miratohet Statuti dhe rregullat e procedurës, komunat administrohen në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/14 mbi Emërimin e administratorëve rajonalë dhe komunalë të datës 21 tetor, 1999 dhe me nenin 8 të Rregullores 2000/1 të UNMIK-ut mbi Këshillin e Përbashkët të Përkohshëm Administrativ të Kosovës të datës 14 janar, 2000, me aso ndryshme të nevojshme që mundësojnë miratimin e Statutit dhe rregullave të procedurës në përputhje me këtë Rregullore.

46.2 Përgjegjësia e administrimit financiar nuk mund t'i transferohet komunës derisa revizori i pavarur të ketë konstatuar se sistemet e menagjimit të përshtatshëm financiar dhe buxhetor janë vendosur dhe shërbimi civil i komunës të ketë kapacitet dhe aftësi për zbatimin e procedurave dhe kontrolleve financiare. Deri në atë kohë, procedurat e menagjimit financiar të caktuara nga UNMIK-u mbeten në fuqi.

Neni 47 Pushteti i i përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm

47.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) e mban tërë pushtetin që i është dhënë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ai e ka fjalën përfundimtare në marrjen e vendimeve përkitazi me çdo dispozite të kësaj Rregulloreje.

47.2 PSSP mund të anulojë çdo vendim të komunës nëse konsideron se është në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Rregulloret e UNMIK-ut apo ligjet tjera në fuqi, dhe nëse ato vendime nuk i marrin parasysh aq sa duhet të drejtat dhe intereset e komuniteteve që jetojnë në territorin e asaj komune.

47.3 PSSP mund t'i kooptojë anëtarë plotësues kuvendit komunal, nëse konsideron këtë të nevojshme, për të siguruar përfaqësimin e të gjitha komuniteteve në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

47.4 PSSP në raste të veçanta mund t'i shkarkojë nga detyra anëtarët e kuvendit komunal, për shkak të sjelljeve shumë të këqija gjatë ushtrimit të detyrave të tyre si anëtarë. Anëtari i cili është shkarkuar nga detyra mund të kërkojë nga Ombudspersoni ta shqyrtojë këtë vendim.

47.5 Nëse PSSP konstaton se Kuvendi komunal vazhdimisht është duke ndërmarrë veprime të cilat nuk mund të sigurojnë kushte për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës, që janë në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ai mund ta shkarkojë Kuvendin dhe të urdhrojë zgjedhje të reja.

47.6 Statuti dhe Rregullat e Procedurës të secilës komunë miratohen në pajtim me procedurat e konsultimit, publikimit dhe aprovimit të caktuara me Urdhresa administrative të cilat i nxjerr PSSP.

47.7 PSSP, me iniciativë të vet ose me kërkesën e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, mund të ndërmerrë masa të tilla të cilat mendon se janë të nevojshme për të siguruar në mënyrë adekuate nevojat e fshatit dhe rrethinës.

47.8 PSSP mund të lëshojë urdhresa administrative për komunat lidhur me menaxhimin e buxhetit komunal, administrimin financiar të komunës, obligimeve kontraktuese dhe procedurave.

47.9 PSSP i ndihmon komunat në vendosjen e kapaciteteve dhe sistemeve qenësore të menagjimit financiar.

47.10 PSSP mund të shkarkojë anëtarin e shërbimit civil të komunës nëse nuk i ka zbatuar detyrat e tij apo saj në mënyrë të paanshme dhe të drejtë, duke mos respektuar dhe vepruar në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 48

Kompetencat e administratorit komunal

48.1 Administratori komunal duhet të ndërtojë me qëllim që të garantojë se vendimet e komunës a në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe ligjeve në fuqi.

48.2 Administratori komunal mund të ndërtojë me qëllim që të garantojë respektimin e parimeve themelore të të drejtave të njeriut dhe trajtimin e tyre të barabartë dhe të mbrojë të drejtat e interesat e komuniteteve.

48.3 Administratori komunal ka të drejtë të suspendojë dhe t'i paraqesë PSSP-së çdo vendim për të cilin konsideron se është në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe të ligjeve në fuqi.

48.4 Administratori komunal në bashkëpunim me PSSP-në duhet të bashkëpunojë në krijimin e kushteve lokale për kthimin e personave të zhvendosur brenda vendit dhe refugjatëve në komunat nga e kanë prejardhjen.

48.5 Administratori komunal e ndihmon komunën në rindërtimin fizik të saj, në inicimin e aktiviteteve për ndërtimin e paqës dhe aktiviteteve e programeve të pajtimit, si dhe në përkrahjen e zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë lokale.

48.6 Administratori komunal i thërret mbledhjet përruese të kuvendit komunal. Ato duhet të mbahen brenda pesëmbëdhjetë ditëve prej publikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga ana e Komitetit Qendror të Zgjedhjeve.

48.7 Derisa të zgjidhet kryetari, administratori komunal thërret dhe udhëheq të gjitha mbledhjet e kuvendit të komunës dhe vepron si kryetar i komunës.

48.8 Administratori komunal duhet të rregullojë bartjen e rregullt dhe progressive të pushtetit nga organet e mëparshme në organet e kuvendit komunal. Ai apo ajo mund të bëjë marrëveshje të tilla që janë të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve në bashkëpunim me dy apo më shumë komuna dhe për koordinimin e aktiviteteve të ndërmarra nga UNMiK-u dhe komunat.

48.9 Administratori komunal ka të drejtë të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e kuvendit komunal dhe komitetet e tij si dhe në mbledhjet e bordit të drejtorëve.

48.10 Nëse administratori komunal mendon se ekzistojnë keqveprime serioze në funksionimin e procedurave të zakonshme, ai apo ajo ka të drejtë t'i knvokojë mbledhjet e kuvendit komunal dhe të komiteteve të tij si dhe të bordit të drejtorëve për të rishqyrtuar rastin.

48.11 Administratori komunal ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë çfarëdo shënimi nga të gjitha organet e komunës si dhe nga shërbimi civil i komunës.

48.12 Administratori miraton çdo emërim apo largim të nëpunësve të lartë nga puna dhe mbikëqyrë të gjitha emërimet e tjera me qëllim që të sigurojë përfaqësim të duhur të komunitetve në ato emërimet. Emërimet dhe shkarkimet e tilla nuk mund të hyjnë në fuqi pa bashkë nënshkrimin e administratorit komunal.

48.13 Administratori komunal miraton buxhetin dhe siguron që burimet financiare të shpenzohen konform buxhetit, se të gjitha vendimet në aspektin financiar janë marrë në mënyrë të drejtë dhe transparente dhe se të gjitha pagesat janë regjistruar me rregull. Vendimet për miratim apo ndërrim të buxhetit nuk hyjnë në fuqi, nëse nuk janë bashkë nënshkruar nga administratori komunal.

48.14 Administratori komunal do të vazhdojë të jetë përgjegjës për administrimin e pronës përbrenda komunës derisa të drejtat pronësore të mos definoen me ligjet në fuqi.

Neni 49

Komiteti i komuniteteve dhe komiteti për ndërmjetësim

49.1 Administratori komunal emëron anëtarët e komitetit të bashkësive kombëtare dhe të komitetit për ndërmjetësimi.

49.2 Administratori komunal emëron kryesuesin e zyrës së bashkësive të komunës dhe personelin e zyreve të bashkësive të komunës dhe mund t'i themelojë nënzyrat e zyrës së komunitetit.

49.3 E drejta e komiteti të komuniteteve, e precaktuar në kapitullin 2, neni 23.9, për t'ia paraqitur një vendim Pushtetit Qendror do të kryhet pajtim me procedurat që do t'i përcaktojnë PSSP.

Neni 50
Mandati i kryetarit

Çdokush mund të emërohet në dy mandate si kryetar i komunës përveç mandatit të parë.

Neni 51
Emërimi i bordit të drejtorëve

Kryetari, me pëlqimin e administratorit të komunës, propozon anëtarët e bordit të parë të drejtorëve. Emërimi me pako i dorëzohet kuvendit të komunës për miratim.

Neni 52
Emërimet në shërbimin civil komunal

Komunat duhet t'i kenë emëruar shërbimet civile komunale sipas procedurave zyrtare të rekrutimit para zgjedhjeve. Zgjedhjet nuk mund të jenë shkak për rishqyrtimin e këtyre emërimeve.

Neni 53
Interpretimi

Dispozitat e kapitullit 1 deri 8 të kësaj Rregulloreje hyjnë në fuqi në varësi të dispozitave të kapitullit 9. Aty ku ekziston kolizion në mes të dispozitave në kapitujt 1 deri 8 dhe cilësdo dispozitë në kapitullin 9, vlen dispozita në kapitullin 9.

Kapitulli 10
Prania e sigurisë ndërkombëtare

Asgjë në këtë rregullore nuk mund të ndikojë në pushtetin e Komandantit të Forcave të Kosovës (KFOR) për të përmbushur të gjitha detyrat në mandatin e KFOR-it sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Kapitulli 11
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhra administrative lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Kapitulli 12 **Ligji në fuqi**

Kjo Rregullore shfuqizonë çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Kapitulli 13 **Hyrja në Fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 11 gusht 2000.

Bernard Kouchner
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm